

SHTOJCA C: Korniza e shërbimeve dhe shumat maksimale të honorarit të ndihmës juridike**PJESA 1: KORNIZA E SHËRBIMEVE NË PËRPUTHJE ME RREGULLAT 13(1)(c) DHE 17 TË RREGULLORES PËR NDIHMË JURIDIKE (RRNJ)**Korniza e shërbimeve të ofruara nga mbrojtësi i caktuar përcaktohet si vijon¹:

PJESA 1	Faza para aktakuzës	Faza e procedurës paraprake	Faza e gjykimit	Faza e apelit në shkallë të dytë	Faza e apelit në shkallë të tretë
Deri në përcaktimin e nivelit të kompleksitetit	Tarifa për orar jo të plotë pune/për orë pune ²	Orar i plotë pune në çështje me kompleksitet të nivelit 1	Orar i plotë pune në nivel kompleksiteti të fazës së procedurës paraprake	Orar i plotë pune në nivel kompleksiteti të fazës së gjykimit	Orar i plotë pune në çështje me kompleksitet të nivelit 1
Pas përcaktimit të nivelit të kompleksitetit	Tarifa për orar jo të plotë pune/për orë pune ³	Orar i plotë pune në nivel të përcaktuar kompleksiteti	Orar i plotë pune në nivel të përcaktuar kompleksiteti	Orar i plotë pune në nivel të përcaktuar kompleksiteti	Orar i plotë pune në nivel të përcaktuar kompleksiteti
Sipas vendimit të Administratorit në përputhje me rregullat 17(1)(b) dhe 18(2)	nuk zbatohet			Orar jo i plotë pune	orar jo i plotë pune

PJESA 2(1): SHUMAT MAKSIMALE PËR LLOGARITJEN E SHPËRBLIMIT SIPAS RREGULLAVE 13(1)(d) dhe 14(a) TË RRNJ-SËNë bazë të kornizës së shërbimeve (me orar të plotë pune, me orar jo të plotë pune, për orë pune), shumat maksimale⁴ të pagesës sipas rregullave 13(1)(d) dhe 14(a) të RRNJ-së janë si vijon:

PJESA 2(1)	Faza para aktakuzës		Faza e procedurës paraprake	Faza e gjykimit	Faza e apelit në shkallë të dytë		Faza e apelit në shkallë të tretë	
	orar jo i plotë pune/ muaj	tarifa për orë pune	orar i plotë pune/ muaj	orar i plotë pune/ muaj	orar i plotë pune/ muaj	orar jo i plotë pune/gjithsej ⁵	orar i plotë pune/ muaj	orar jo i plotë pune/gjithsej
Shpërblimi për kompleksitet të nivelit 1			26.830 euro	26.830 euro	26.830 euro		26.830 euro	
Shpërblimi për kompleksitet të nivelit 2	4.800 euro	100 euro	31.470 euro	31.470 euro	31.470 euro	41.760 euro	31.470 euro	41.760 euro
Shpërblimi për kompleksitet të nivelit 3			40.750 euro	40.750 euro	40.750 euro		40.750 euro	

¹ Gjatë procedurës paraprake, shërbimet me orar të plotë mund të konvertohen në shërbime me orar jo të plotë në rast të ngarkesës së reduktuar të punës, pas një vendimi të gjykatës për pezullimin e procesit sikurse përcaktohet në rregullën 17(5).

² Si rregull, pagesa bëhet në bazë të tarifës për orë pune; tarifa për orar jo të plotë pune zbatohet vetëm nëse Administratori merr një vendim të tillë në përputhje me rregullat 17 dhe 18 të RRNJ-së.

³ Shih poshtëshënimin 1.

⁴ Në lidhje me shërbimet me orar jo të plotë, për të cilat zbatohet pjesa 2(1), shih rregullën 17.

⁵ "Gjithsej" do të thotë shuma e gjithsejtë për të tërë periudhën e mbetur (domethënë që nga fillimi i ofrimit të shërbimeve me orar jo të plotë deri në shqiptimin e aktgjykimit) që përbën bazën për llogaritjen e honorarit të ndihmës juridike për atë periudhë

SHTOJCA C: Korniza e shërbimeve dhe shumat maksimale të honorarit të ndihmës juridike

Shumat e shpërblimeve të cituara më lart janë shumat maksimale për llogaritjen e shpërblimit të gjithsejtë përmendur në rregullën 14(a) të RRNJ-së.

Pagesa e honorarit të ndihmës juridike, përfshirë shpërblimin, bëhet në pajtim me rregullën 19 të RRNJ-së.

Në përputhje me nivelin e kompleksitetit, ekipi pritet të ketë përbërjen e mëposhtme:

- **Kompleksitet i nivelit 1** në fazën e procedurës paraprake, fazën e gjykimit dhe fazat e apelit: 1 mbrojtës, 1 bashkëmbrojtës, 1 ndihmës juridik dhe 1 ndihmës administrativ i ekipit;
- **Kompleksitet i nivelit 2** në fazën e procedurës paraprake, fazën e gjykimit dhe fazat e apelit: 1 mbrojtës, 1 bashkëmbrojtës, 2 ndihmës juridikë dhe 1 ndihmës administrativ i ekipit;
- **Kompleksitet i nivelit 3** në fazën e procedurës paraprake, fazën e gjykimit dhe fazat e apelit: 1 mbrojtës, 1 bashkëmbrojtës, 4 ndihmës juridikë and 1 ndihmës administrativ i ekipit.

PJESA 2(2): SHUMA MAKSIMALE PËR LLOGARITJEN E SHPËRBLIMIT SIPAS RREGULLAVE 13(1)(e) dhe 14(a) TË RRNJ-SË

Në bazë të kornizës së shërbimeve (me orar të plotë pune, me orar jo të plotë pune, për orë pune), shumat maksimale⁶ të pagesës sipas rregullave 13(1)(e) dhe 14(a) të RRNJ-së janë si vijon:

SECTION 2(2)	Faza para aktakuzës	Faza e procedurës paraprake	Faza e gjykimit	Faza e apelit në shkallë të dytë		Faza e apelit në shkallë të tretë	
	tarifa për orë pune ⁷	orar i plotë pune/ muaj	orar i plotë pune/ muaj	orar i plotë pune/ muaj	tarifa për orë pune ⁸	orar i plotë pune/ muaj	tarifa për orë pune ⁹
Shpërblimi për kompleksitet të nivelit 1	100 euro	6,875 euro	6,875 euro	6,875 euro	100 euro	6,875 euro	100 euro
Shpërblimi për kompleksitet të nivelit 2		12,675 euro	12,675 euro	12,675 euro		12,675 euro	
Shpërblimi për kompleksitet të nivelit 3		14,850 euro	14,850 euro	14,850 euro		14,850 euro	

⁶ Në lidhje me shërbimet me orar jo të plotë, për të cilat zbatohet pjesa 2(2), shih rregullën 17 dhe poshtëshënimin 7.

⁷ Rregullorja për Ndihmë Juridike në këtë fazë të procesit bazohet në tarifën për orë pune për mbrojtësin e caktuar. Gjithsesi, në raste kur honorari i ndihmës juridike bazohet në tarifën për orë pune, ai nuk tejkalon gjysmën e honorarit të ndihmës juridike për shërbimet me orar të plotë pune sipas nivelit të kompleksitetit.

⁸ Shih poshtëshënimin 7.

⁹ Shih poshtëshënimin 7.

SHTOJCA C: Korniza e shërbimeve dhe shumat maksimale të honorarit të ndihmës juridike

PJESA 3(1): CAKTIMI I SHPENZIMEVE NË PËRPUTHJE ME RREGULLËN 14(b) TË RRNJ-së

Për mbulimin e shpenzimeve që dalin gjatë fazave të ndryshme të procesit, mbrojtësit të caktuar i caktohen shumat e mëposhtme:

Shumat mujore që i caktohen mbrojtësit të caktuar për mbështetjen e përfaqësimit të çështjes:

- Shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë: 1.150 euro në muaj;
- Shpenzime të tjera që shefi i Zyrës së Mbrojtjes i gjykon të nevojshme: 500 euro në muaj;

Shuma që i caktohet mbrojtësit të caktuar për kontraktimin e hetuesve/konsulentëve të jashtëm (përfshirë ndihmë në terren):

- gjithsej 40.000 euro për të gjitha fazat e procesit.

Shumat që i caktohen mbrojtësit të caktuar për mbështetjen e kryerjes së hetimeve/konsulentëve (p.sh. udhëtimi):

- o gjithsej 10.000 euro për fazën e procedurës paraprake;
- o gjithsej 20.000 euro për fazën e gjykimit;
- o gjithsej 5.000 euro për fazën e apelit në shkallë të dytë;
- o gjithsej 5.000 euro për fazën e apelit në shkallë të tretë;

Në qoftë se nuk shpenzohen, shumat e caktuara mund të mbarten në muajin apo fazën vijuese të procesit. Shumat e caktuara paguhen vetëm pas dorëzimit të dokumentacionit, konkretisht faturave që vërtetojnë se mbrojtësi i caktuar faktikisht i ka kryer dhe paguar shpenzimet.

PJESA 3(2): CAKTIMI I SHPENZIMEVE NË PËRPUTHJE ME RREGULLËN 14(b) TË RRNJ-së

Për mbulimin e shpenzimeve që dalin gjatë fazave të ndryshme të procesit, mbrojtësit të caktuar i caktohen shumat e mëposhtme:

Shumat mujore që i caktohen mbrojtësit të caktuar për mbështetjen e përfaqësimit të çështjes:

- Shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë: 1.150 euro në muaj;
- Shpenzime të tjera që shefi i Zyrës së Mbrojtjes i gjykon të nevojshme: 500 euro në muaj.

Shuma që i caktohet mbrojtësit të caktuar për kontraktimin e hetuesve/konsulentëve të jashtëm (përfshirë ndihmë në terren):

- gjithsej 10.250 euro për të gjitha fazat e procesit.

Shumat që i caktohen mbrojtësit të caktuar për mbështetjen e kryerjes së hetimeve/konsulentëve (p.sh. udhëtimi):

- o gjithsej 2.562 euro për fazën e procedurës paraprake;
- o gjithsej 5.125 euro për fazën e gjykimit;
- o gjithsej 1.281 euro për fazën e apelit në shkallë të dytë;
- o gjithsej 1.281 euro për fazën e apelit në shkallë të tretë.

SHTOJCA C: Korniza e shërbimeve dhe shumat maksimale të honorarit të ndihmës juridike

Në qoftë se nuk shpenzohen, shumat e caktuara mund të mbarten në muajin apo fazën vijuese të procesit. Shumat e caktuara paguhen vetëm pas dorëzimit të dokumentacionit, konkretisht faturave që vërtetojnë se mbrojtësi i caktuar faktikisht ka pasur shpenzime dhe i ka paguar.

PJESA 4: TARIFA PËR ORË PUNE DHE KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE PËR MBROJTËSIN KUJDESTAR DHE MBROJTËSIN E CAKTUAR NË PËRPTHJE ME RREGULLAT 17(4), 21(2) DHE 37(3) TË RRNJ-së:

Tarifa për orë pune për mbrojtësin kujdestar dhe mbrojtësin që i caktohet një të dyshuari ose cilitdo personi tjetër është 100 euro, e faturuar për jo më shumë se 8 orë në ditë (kërkesat për pagesë të më shumë orëve do t'i nënshtrohen vlerësimit nëse janë të arsyetuara). Të gjitha faturat verifikohen nga shefi i njësisë përkatëse të Zyrës së Administrimit. Shpenzimet për udhëtimet e punës kompensohen me miratimin e shefit të njësisë përkatëse të Zyrës Administrative me kusht që mbrojtësi të përmbushë kriteret e përcaktuara nga shefi i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative. Orët e udhëtimit (nga pika e nisjes deri në pikën e mbërritjes) paguhen me gjysmën e tarifës për orë pune, faturuar për një maksimum prej 8 orësh në ditë. Për anëtarët e ekipit të mbrojtësit kujdestar, nëse ka, tarifa për orë pune mund të shtohet me sa vijon: për bashkëmbrojtësin me 85 euro; për një ndihmës juridik me 45 euro; për një ndihmës administrativ të ekipit me 28 euro.